



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Legjislatura III**

Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi  
Mbledhja nr. 11-2008  
Prishtinë, më 22 prill 2008, ora 10:00  
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

**PROCESVERBAL**

i mbledhjes së Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi

**Në mbledhje morën pjesë:** Bahri Hyseni, Adem Salihaj, Ramadan Gashi, Kolë Berisha, Selvije Halimi, Riza Smaka, Bajram Kosumi, Adem Hajdaraj.

**Munguan:** Branisllav Grbiq, Melihate Tërmkolli dhe Džezair Murati

**Të ftuarit:** Merlotti Michel-ekspert nga Zvicra, Lumnije Murati-ZPK, Reshit Gashi-NDI, Lejla Selimi-OSBE, Haxhi Gashi-USAID, Edita Kusari-EUPT, Robert Steere-NCSC.

**Nga stafi i Komisionit:** Idriz Tahiri, Behlul Zeka dhe Sulltane Gashi.

**Mbledhjen e kryesoi:** Bahri Hyseni, kryetar i Komisionit, me këtë:

**REND DITE**

1. Miratimi i rendit të ditës
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 10 prillit 2008
3. Shqyrtimi i propozimamendamenteve në Projektligjin e procedurës jokontestimore dhe të procedurës përmbareuse
4. Të ndryshme

## 1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari i njoftoi të pranishmit për propozimin e rendit të ditës dhe propozoi që në pikën të ndryshme për Projektligjin për noterinë të prezantojë ekspertin nga Zvicra, Merlotti Michel.

*Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.*

## 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 1 prillit 2008

**Kryetari** – I pyeti anëtarët për vërejtje eventuale për procesverbalin.

*Procesverbali u miratua pa vërejtje.*

## 3. Shqyrtimi i propozimamendamenteve në Projektligjin e procedurës jokontestimore dhe të procedurës përmbarese

**Kryetari** - I lexoi propozimamendamentet e Projektligjit të procedurës përmbarese. Komisioni i shqyrtoi një nga një propozimamendamentet.

*Pas shqyrtimit të kësaj pike, Komisioni njëzëri i miratoi propozimamendamentet me disa ndryshime që u propozuan gjatë shqyrtimit. Staf i mbështetës do ta përgatitë sa më parë raportin përfundimtar për seancën e Kuvendit.*

## 4. Të ndryshme

### Projektligji për noterinë

**Kryetari** - Duke u ndërlidhur me Projektligjin e falënderoi ekspertin që iu ka përgjigjur ftesës dhe vuri në pah se Komisioni më 2 shkurt 2008 e ka mbajtur një dëgjim publik për këtë projektligj dhe se transkripti nga dëgjimi i mbajtur i është dorëzuar edhe ekspertit. Në këtë dëgjim publik kanë kontribuar të ftuar të ndryshëm, si dhe përfaqësuesit e USAID -it dhe të NCSC-së.

**Haxhi Gashi** - Përfaqësues i USAID-it - nënvizoi se versioni i Projektligjit në gjuhën shqipe, pas përkthimit, e ka humbur kuptimin. Ky projektligj së pari është përkthyer nga gjuha frënge në gjuhën angleze dhe pastaj nga gjuha angleze në gjuhën shqipe. Ai më tutje shtoi se sa u përket definicioneve ekspertit është shprehur se nuk ka nevojë fare për ato, ngase normat duhet të jenë të qarta.

**Riza Smaka** - Propozoi të organizohet një tryezë në të cilën do të diskutohet për këtë institucion të ri në Kosovë.

**Kryetari** - Theksoi se një dëgjim publik ka qenë i organizuar për këtë projektligj dhe tash duhet vetëm t'i ngremë çështjet si: Pse duhet të kemi raste në të cilat për dy komuna do ta

kemi vetëm një noter? Pse duhet të kemi një noter për 30 mijë banorë? A është ky numër i mjaftueshëm? Kush e zgjedh noterin?

**Merlotti Michel** - Ekspert nga Zvicra- i falënderoi anëtarët e Komisionit për mundësinë e prezantimit para tyre. Ai theksoi se ka qenë i angazhuar nga ana e UNMIK-ut për të punuar në hartimin e Projektligjit për noterinë dhe se për këtë projektligj është punuar në periudhën 2004 - 2006. Ai nënvizoi se Projektligji është hartuar sipas praktikave më të mira ndërkombëtare dhe konform të gjitha procedurave noteriale. Në botë janë 77 vende që punojnë me këtë sistem - ndër to edhe Republika e Shqipërisë, Maqedonia, Bosnja dhe Hercegovina, Sllovenia etj. Ai shtoi se tash e ka kuptuar se përkthimi në gjuhën shqipe nuk është i qartë, por versioni në gjuhën angleze është shumë i mirë. Në lidhje me përkufizimet theksoi se tash e kuptuar se praktika në Kosovë është të vendosen ato në fillim të Projektligjit dhe kjo do të përmirësohet. Sa i përket numrit të noterëve, kjo varet nga kompetencat që do t'i jepen noterisë – kjo mund të shkojë nga vërtetimet për automjetet e deri te vërtetimi i dokumenteve (certifikatave) etj. Ai më tutje shtoi se nuk është në favor të një numri të madh noterësh dhe se 100 noterë do të mjaftonin për 2.5 milionë banorë. Në diskutimet fillestare gjatë hartimit të këtij projektligjit, ka qenë një propozim që 1 noter të caktohet për 20 mijë banorë, por në ndërkohë ishte ndryshuar për 30 mijë banorë. Ai nënvizoi se numri prej 100 noterësh do të ishte i mjaftueshëm për të filluar, ndërsa në ndërkohë do të ndryshonte. Tash ka tendenca të mos përdoret numerus clausus. Eksperti, Merlotti Michel, theksoi se do t'i shqyrtojë të gjitha amendamentet nga leximi i parë, transkriptin dhe do të qëndrojë në Kosovë deri të premtën dhe në fund do ta përgatitë një raport për Projektligjin.

**Kryetari** – Duke u ndërlidhur me prezantimin e parafolësit shtoi se duhen të rregullohen çështja e definicioneve, numri i noterëve dhe sidomos ajo e një noteri që i mbulon dy komuna. Këto duhet të shqyrtohen edhe një herë.

**Riza Smaka** - Theksoi se ai personalisht konsideron se numri i noterëve nuk duhet të kufizohet, por t'u lihet kërkesave të tregut, të bëhet sikurse me avokatët, mbasi noterët nuk paguhen nga buxheti i Kosovës.

**Merlotti Michel** - Theksoi se avokatët bëjnë punë të ndryshme. Avokatët varen nga pushteti gjyqësor, ndërsa noterët nga pushteti legjislativ dhe nga ai ekzekutiv. Noteri i jep fuqi ekzekutive dokumentit shumë më tepër se sa avokati. Noteri e fiton të drejtën që ta vërë vulën në kodin e Kosovës dhe kjo nuk ka të bëjë me marrëveshjen, siç bëhet me rastin e avokatëve.

**Haxhi Gashi** - Pyeti nëse ka mundësi të këtë konkurrencë ndërmjet noterëve.

**Merlotti Michel** - Në cilësinë e ekspertit nënvizoi se noteri duhet të emërohet nga Ministria e Drejtësisë që do t'i caktojë numrin dhe tarifën e tyre. Ndërsa përkritazi me emërimin e noterëve, Projektligji thotë se 4 noterë e përbejnë Komisionin. Në rastin kur nuk kemi fare noterë, në fillim mund t'i kemi 4 anëtarë që mund të jenë gjykatës ose profesorë që do ta bëjnë vetëm emërimin e noterëve të parë. Më vonë noterët bëhen pjesë e Komisionit që do ta vazhdojnë punën sipas Projektligjit. Ai vuri në pah se zbatimi i sistemit noterial do të zgjasë gati 2 vjet dhe nuk mund të bëhet për 6 muaj.

Kryetari i falënderoi edhe një herë të pranishmit dhe e shpalli mbledhjen të mbyllur në orën 14:00.

*Procesverbalin e hartoi:*  
Behlul Zeka, zyrtar ligjor

**Kryetari i Komisionit**

---

Bahri Hyseni